| | | |
|---|---|---|
| | **Republika e Kosovës**<br>Republika Kosova – Republic of Kosovo<br><br>**Komuna e Prishtinës**<br>Opština Priština –Municipality of Prishtina | PRISHTINA |

Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika "d" e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika "d" e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 12 të Udhëzim Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr.391/02-8714/24 dt. 16.01.2024, pronarëve Burim dhe Valon Gashi, Arianit, Genc dhe Blerim Alaj, Selim Mustafa, Ramiz Gashi, Nezir Musatafa, Xhyla Jakupi, Shaip Xhelili, Lumnije Gashi, Preveza Abrashi, Vjollca Hoxha-Gashi, Mrika Hoxha, Dardan Kelmendi, Vahide, Selatin, Arbrora, Perparim, Gazmend, Ardona, Diamant, Alberina, Fazli, Sadri dhe Jakup Gashi, Asdren Kelmendi, Skender, Naman, dhe Zymer Gashi, N.N. "R&Rukolli" sh.p.k. Ali Mehmeti, Rrahman dhe Ismet Duli, Mimoza Lokaj, Rexhep Mustafa, Arianit Makolli, Myrvete Rizvanolli, Albulena, Lauras, Albulen dhe Drenushë Meha, Rrezarta Zeka-Meha, Latif Hasani, Osman Osmani, Ahmet Rrahmani, Besnik, Imer dhe Ismet Gashi dhe Sabri Kadriu nga Prishtina, nga Prishtina, me investitor "R&Rukolli" Sh.P.K. nga Skenderaj, rr. "18 Qershori", me certifikatë të regjistrimit ARBK 810618366, me përfaqësues Rrustem Rukolli, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për kompleksin e ndërtesave shumë banesore me afarizëm, të emërtuara si "Lamela B" dhe " Lamela C" me etazhitet 2B+S+P+14ET, të ndërtuara në kuadër të bllokut urban "b_09" të nën tërësisë "B-2", të tërësisë "B" të Planit rregullues "Muhaxhirët", në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë të rregullt administrative, me datën 11.12.2024 lëshon këtë:

## CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

**I. I LEJOHET** pronarëve Burim dhe Valon Gashi, Arianit, Genc dhe Blerim Alaj, Selim Mustafa, Ramiz Gashi, Nezir Musatafa, Xhyla Jakupi, Shaip Xhelili, Lumnije Gashi, Preveza Abrashi, Vjollca Hoxha-Gashi, Mrika Hoxha, Dardan Kelmendi, Vahide, Selatin, Arbrora, Perparim, Gazmend, Ardona, Diamant, Alberina, Fazli, Sadri dhe Jakup Gashi, Asdren Kelmendi, Skender, Naman, dhe Zymer Gashi, N.N. "R&Rukolli" sh.p.k. Ali Mehmeti, Rrahman dhe Ismet Duli, Mimoza Lokaj, Rexhep Mustafa, Arianit Makolli, Myrvete Rizvanolli, Albulena, Lauras, Albulen dhe Drenushë Meha, Rrezarta Zeka-Meha, Latif Hasani, Osman Osmani, Ahmet Rrahmani, Besnik, Imer dhe Ismet Gashi dhe Sabri Kadriu nga Prishtina, me investitor "R&Rukolli" Sh.P.K. nga Skenderaj me certifikatë të regjistrimit ARBK 810618366, me përfaqësues Rrustem Rukolli, sipas kërkesës 05 Nr.391/02-8714/24 dt. 16.01.2024, përdorimi i kompleksit të ndërtesave shumë banesore me afarizëm, të emërtuara si "Lamela B" dhe " Lamela C" me etazhitet 2B+S+P+14ET, të ndërtuara në kuadër të bllokut urban "b_09" të nëntërësisë "B-2" të tërësisë "B" të Planit rregullues "Muhaxhirët", gjegjësisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 10540-0, Zona Kadastrale Prishtinë, sipas Vendimit të lejes ndërtimore 05 Nr.351/02-150723/18 dt. 27.11.2018.

**II.** Ndërtesat nga pika I. e këtij vendimi, ndodhen në rrugën "Kaçaniku" ku kanë dalje hyrjet e kësaj ndërtese me numrat: 96, 98, 100, 102, 104, 106, 108, 110, 112, 114, 116, 118, 120, 122 dhe 124 në Prishtinë, dhe të njëjtat do të përdoren dhe shfrytëzohen sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

III. Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e kompleksit të ndërtesave dhe njësive të tyre në evidencat e regjistrit kadastral.
IV. Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzim Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

**A r s y e t i m**

Pronarët Burim dhe Valon Gashi, Arianit, Genc dhe Blerim Alaj, Selim Mustafa, Ramiz Gashi, Nezir Musatafa, Xhyla Jakupi, Shaip Xhelili, Lumnije Gashi, Preveza Abrashi, Vjollca Hoxha-Gashi, Mrika Hoxha, Dardan Kelmendi, Vahide, Selatin, Arbrora, Perparim, Gazmend, Ardona, Diamant, Alberina, Fazli, Sadri dhe Jakup Gashi, Asdren Kelmendi, Skender, Naman, dhe Zymer Gashi, N.N. "R&Rukolli" sh.p.k. Ali Mehmeti, Rrahman dhe Ismet Duli, Mimoza Lokaj, Rexhep Mustafa, Arianit Makolli, Myrvete Rizvanolli, Albulena, Lauras, Albulen dhe Drenushë Meha, Rrezarta Zeka-Meha, Latif Hasani, Osman Osmani, Ahmet Rrahmani, Besnik, Imer dhe Ismet Gashi dhe Sabri Kadriu nga Prishtina, nga Prishtina, me investitor R&Rukolli" Sh.P.K. nga Skenderaj me certifikatë të regjistrimit ARBK 810618366, me përfaqësues Rrustem Rukolli, më kërkesën me 05 Nr.391/02-8714/24 dt. 12.01.2024, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për kompleksin e ndërtesave shumë banesore me afarizëm, të emërtuara si "Lamela B" dhe " Lamela C" me etazhitet 2B+S+P+14ET, në lokacionin e përshkruar si në pikën I. të dispozitivit të kësaj certifikate.

Paraprakisht Drejtoria e Inspeksionit-Sektori i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare "Akt përcjellës", me referencë, me referencë 09 Nr. 391/02-101238/23 dt. 29.05.2023, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizimit, Raportet e Njoftimin mbi Inspektimit Final të punëve dhe përshkrimit të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkuesit kanë prezantuar dokumetacionin sipas Shtojca 5 të e Udhëzim Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/1.Inspektimi i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.1.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.2.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.c.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.d.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/3.Inspektimi i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/4.Inspektimi i instalimeve të ujit; Fotografi gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testimeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të ndërtesës, nga udhëheqësi i punishtes Valdrin Gashi; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikëqyrësi Valdrin Muqaj; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikëqyrësi Ragip Behrami; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, nga mbikëqyrësi Avdi Çitaku; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektrike, nga mbikëqyrësi Remzije Ahmeti; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikëqyrësi Agron Musliu; Raportin e përfundimit të punëve për mbrojtje nga zjarri, nga Ruzhdi Feka, Incizimin gjeodezik të objektit dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga gjeodeti i licencuar për kryerjen e matjeve kadastrale Taulant Sabedinaj me nr. të licencës 41.



Komuna e Prishtinës-Drejtoria e Urbanizmit
Adresa: rr. "Radovan Zogoviq" nr. 1, 10000, Prishtinë-Kosovë
Telefon: +383 (0) 38 221 242 e-mail: urbanizmiprishtine@rks-gov.net

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspektimit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesat shumë banesore me afarizëm mund të përdoren.

Sipas dëshmisë mbi pronësinë për parcelën kadastrale 10540-0, Zona Kadastrale Prishtinë, pronar të saj janë Burim dhe Valon Gashi, Arianit, Genc dhe Blerim Alaj, Selim Mustafa, Ramiz Gashi, Nezir Musatafa, Xhyla Jakupi, Shaip Xhelili, Lumnije Gashi, Preveza Abrashi, Vjollca Hoxha-Gashi, Mrika Hoxha, Dardan Kelmendi, Vahide, Selatin, Arbrora, Perparim, Gazmend, Ardona, Diamant, Alberina, Fazli, Sadri dhe Jakup Gashi, Asdren Kelmendi, Skender, Naman, dhe Zymer Gashi, N.N. “R&Rukolli” sh.p.k. Ali Mehmeti, Rrahman dhe Ismet Duli, Mimoza Lokaj, Rexhep Mustafa, Arianit Makolli, Myrvete Rizvanolli, Albulena, Lauras, Albulen dhe Drenushë Meha, Rrezarta Zeka-Meha, Latif Hasani, Osman Osmani, Ahmet Rrahmani, Besnik, Imer dhe Ismet Gashi dhe Sabri Kadriu nga Prishtina, përderisa posedues të lejes ndërtimore janë Selim Mustafa, Nezir Musatafa, Xhyla Jakupi, Shaip Xhelili, Ali Mehmeti, Rrahman dhe Ismet Duli, Mimoza Lokaj, Rexhep Mustafa, Arianit Makolli, Osman Osmani nga Prishtina dhe investitorit “ R&Rukolli” Sh.P.K. pasi që, në ndërkohë, me aktet noteriale; “Kontratë për ndërtimin e përbashkët dhe rregullimin e raporteve pronësore” e përpiluar te noteri Sefedin Blakaj në Prishtinë me Nr. LRP-së 11584/2019 dhe Nr. REF. 2337/2019, “Kontratë për ndërtimin e përbashkët dhe rregullimin e raporteve pronësore” e përpiluar te noteri Sefedin Blakaj në Prishtinë me Nr. LRP-së 14730/2019 dhe Nr. REF. 3087/2019, “Kontratë për ndërtimin e përbashkët dhe rregullimin e raporteve pronësore” e përpiluar te noteri Sefedin Blakaj në Prishtinë me Nr. LRP-së 13827/2019 dhe Nr. REF. 2887/2019, “Kontratë për ndërtimin e përbashkët dhe rregullimin e raporteve pronësore” e përpiluar te noteri Sefedin Blakaj në Prishtinë me Nr. LRP-së 14612/2020 dhe Nr. REF. 3415/2020, “Kontratë për ndërtimin e përbashkët dhe rregullimin e raporteve pronësore” e përpiluar te noteri Sefedin Blakaj në Prishtinë me Nr. LRP-së 4848/2017 dhe Nr. REF. 902/2017, “Kontratë për ndërtimin e përbashkët dhe rregullimin e raporteve pronësore” e përpiluar te noteri Sefedin Blakaj në Prishtinë me Nr. LRP-së 9377/2020 dhe Nr. REF. 2137/2020, “Kontratë për ndërtimin e përbashkët dhe rregullimin e raporteve pronësore” e përpiluar te noteri Sefedin Blakaj në Prishtinë me Nr. LRP-së 332/2021 dhe Nr. REF. 333/2021, “Kontratë për ndërtimin e përbashkët dhe rregullimin e raporteve pronësore” e përpiluar te noteri Sefedin Blakaj në Prishtinë me Nr. LRP-së 325/2017 dhe Nr. REF. 49/2017, “Kontratë për ndërtimin e përbashkët dhe rregullimin e raporteve pronësore” e përpiluar te noteri Sefedin Blakaj në Prishtinë me Nr. LRP-së 10375/2020 dhe Nr. REF. 2344/2020, “Kontratë-Marrëveshje për ndarjen e njësive nga ndërtimi i përbashkët” e përpiluar te noteri Sefedin Blakaj në Prishtinë me Nr. LRP-së 7563/2022 dhe Nr. REF. 2535/2022, “Kontratë për ndërtimin e përbashkët” e përpiluar te noteri Arbena Shehu në Prishtinë me Nr. LRP-së 1459/2014 dhe Nr. REF. 332/2014, janë ndërruar pronarët e parcelës nr.10221-0 në të cilën është lëshuar Leja e Ndërtimit duke u bashkuar me parcelat nr. 1672-1, 1672-2, 1672-3, 1672-4, 1672-5, 1672-6, 2672-18, 2672-19, 2672-20, 2672-22, 2672-23 dhe 2672-24 sipas kontratave të lartshënuara dhe duke formuar parcelën nr. 10540-0, Zona Kadastrale Prishtinë, dhe rrjedhimisht Certifikata e Përdorimit lëshohet në emër të të njëjtëve.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzim Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat



Komuna e Prishtinës-Drejtoria e Urbanizmit
Adresa: rr. "Radovan Zogoviq" nr. 1, 10000, Prishtinë-Kosovë
Telefon: +383 (0) 38 221 242 e-mail: urbanizmiprishtine@rks-gov.net

nga Ligji për Ndërtim nr. 04/L-110, janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezantuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që kompleksi i ndërtesave shumë banesore me afarizëm mund të përdoren, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për kompleksin e ndërtesave shumë banesore me afarizëm.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certifikate.

**Udhëzimi juridik:** Pala e pakënaqur me këtë Certifikatë, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certifikate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI

**Ky vendim u printua në 6 (gjashtë) kopje identike dhe i dërgohet:** Kërkuesve/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,**
**05 NR. 391/02-8714/24 DT. 11.12.2024**

Zyrtari,
Berim Osmanaj

Udhëheqëse e Sektorit,
Nazife Krasniqi



Komuna e Prishtinës-Drejtoria e Urbanizmit
Adresa: rr. "Radovan Zogoviq" nr. 1, 10000, Prishtinë-Kosovë
Telefon: +383 (0) 38 221 242 e-mail: urbanizmiprishtine@rks-gov.net